



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 266/1 Prot.

Elbasan më 5.3. 2021

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.11 datë 23.02.2021 “Për caktim agjenti tatimor për vitin 2021”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Klevis Xhoxhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 1214/3 prot

D. 26.02.2021

Nr.11 dt. 23.02.2021

“PER CAKTIM AGJENTI TATIMOR PER VITIN 2021”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me Ligjin nr.106/2017, datë 30.11.2017, VKM Nr. 132 , datë 07.03.2018" Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme "NDERTESA" e bazës së taksës për kategori specifike", VKB nr 106 datë 27.11.2020 " Per Miratimin e taksave dhe tarifave Vendore per Vitin 2021". Keshilli bashkiak I mbledhur sot me datë 23.02.2021 dhe me propozim të Kryetarit të bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Agjent Tatimor Sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Librazhd për vjeljen e tarifës së pastrimit, taksës së ndërtesës, tarifës së gjelbërimit, tarifës së ndricimit të abonentëve familjar për vitin 2021.
2. Masa e shpërblimit të agentit tatimor për tarifën do të jetë 1 % e vlerës së arkëtuar.
3. Vjelja e detyrimit të pasqyrohet në faturën tatimore, detyrimi për cdo familje do të përpjestohet në muaj sipas marreveshjes që do të lidhet me ujesjetllës.
4. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e të Ardhurave Vendore ,Bashkia Librazhd .
5. Ky urdher hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sek.i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KËSHILLIT
Shefki Bahiti

